



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE ALBANIA SHA dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifat përkatëse të shërbimeve, si edhe mënyra e tarifimit.

○ SHËRBIMI MIX & MAX

1. Të gjithë pajtimtarët e shërbimeve mobile dhe fiks kanë mundësi të bëhen pjesë e shërbimit Mix & Max:

Plani Mix & Max	Përfitimet e kombinuara të shërbimeve Mobile + Internet/TV	Pajtimi Mijor i zbritur për shërbimin e kombinuar Mix & Max (Lekë)
MixMax Go More_Tring e Plote 100 Mbps	One Go More & One Ultra Fiber Tring e Plote 100Mbps	2,500

2. Linjat e telefonisë celulare dhe Internet ose IPTV, pjesë të përfitimeve Mix & Max mund të mbyllen me kërkesë të pajtimtarit:

- Nëse mbyllet njëri nga shërbimet mobile apo fiks, automatikisht do të përjashtohet nga zbritja e përfituar nga shërbimi Mix & Max, dhe për muajt e mbetur do të tarifohet me tarifen standarde të paketës.

Në rast përfundimi të paketës përpara afatit fillestar, do të aplikohen parashikimet e kushteve të përgjithshme.

3. Pajtimtarët që do të bëhen pjesë e shërbimit Mix & Max do të përfitojnë çmimin e zbritur për të gjitha shërbimet së bashku.
4. Planet Mix & Max ofrohen në kontrata 24 mujore.
5. Për klientët e rinjë aktivizimi në shërbimet fikse do të jetë pa asnjë kosto instalimi.
6. Pajtimtarët do të marrin një faturë të vetme për të gjitha shërbimet celulare dhe fikse.
7. Planet mobile dhe fikse mund të përfitojnë nga ky shërbim duke kaluar në një nga kombinimet e dhëna më sipër.

Detaje për paketat Fikse

- Shërbimi PSTN nuk ofrohet në këto kombinime.
 - Paketat IPTV kanë shërbime të tjera të IPTV-së të tilla si: Menu, Guide, Kod PIN për personalizim dhe kontroll.
 - Paketat IPTV me kanale televizive të platformës Tring kanë shërbimin VoD 3 muaj nga momenti i aktivizimit.
 - Paketat kanë IP Dinamike.
 - Instalimi i shërbimit do të ofrohet falas.
 - Për pajtimtarët e rinj në shërbimin internet /IPTV, Modemi dhe Dekoderi jepen në përdorim. Këto pajisje duhet të kthehen në rast të përfundimit të Kontratës. Nëse Pajtimtari nuk i kthen pajisjet, atëherë Pajtimtari do ta paguajë vlerën e pajisjeve.
 - Kërkesa për ndryshim lidhur me IP nuk do të konsiderohet si përfundimi i Lidhjes dhe nuk do të ndikojë në afatin e vlefshmërisë së kësaj Lidhjeje.
8. Nëse kontrata e numrit fiks ose mobile mbyllet me kërkesë të pajtimtarit apo për arsye mospagesash, atëherë zbritja nuk do të përfitohet automatikisht.



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

9. ONE mund t'i ndryshojë në çdo kohë këto "Kushte dhe Afate", vetëm nëpërmjet Njoftimit individual të pajtimtarit (sips përcaktimeve në kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve) të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre, njoftim i cili në rastet kur nuk përmban detaje të mjaftueshme të ndryshimeve, do të përmbajë adresën se ku janë publikuar ndryshimet përkatëse. Nëse Pajtimtari i ONE brenda 30 diteve nga data e Njoftimit nuk bën kërkesë për mbyllje të shërbimit Mix & Max, automatikisht do të hyjnë në fuqi kushtet e reja për përdorimin dhe përfitimet e shërbimit Mix & Max.

SHËNIME TË PËRGJITHSHME

1. Të gjitha tarifat e përcaktuara më sipër përfshijnë TVSH-në.
2. Njësitë e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 muaj dhe nuk janë të transferueshme në muajt në vijim.
3. Pajtimi mujor për muajin e parë të aktivizimit të kësaj pakete do të jetë proporcional në varësi të datës së aktivizimit. Pajtimtari mund të ndryshojë në çdo kohë planin e tij tarifor, në një plan tjetër tarifor me pajtim mujor më të lartë.
4. Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë ofertë promociionale, si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promociionale, dhe vendos që të ndryshojë planin tarifor, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë, në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, duhet të paguajë edhe përfitimet e marra nga oferta promociionale (shumën e zbritjeve të përfituara për të gjithë periudhën promociionale).
5. Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë ofertë promociionale, si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promociionale, dhe vendos që të mbyllë kontratën, duhet të paguajë edhe përfitimet e marra nga oferta promociionale (shumën e zbritjeve të përfituara për të gjithë periudhën promociionale).
6. Përfshirë, në faturën e parë të lëshuar do të pasqyrohen: deryrimi i muajit paraardhës (i llogaritur proporcionalisht, sipas aktivizimit të planit tarifor) dhe pagesa fikse mujore e muajit aktual. Në vijim, pagesat fikse mujore të paketës së zgjedhur do të aplikohen çdo datë 1 të muajit kalendarik. Si rrjedhojë, në çdo faturë mujore të lëshuar në vijim, pas faturës së parë, do të shfaqet vetëm vlera e pagesës mujore fikse e muajit aktual, sipas planit tarifor të zgjedhur.
7. ONE Albania ka të drejtë të aplikojë një ndryshim të tarifave të një apo më shumë shërbimeve bazuar në ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT), duke iu referuar treguesit të vitit paraardhës. Operatori ka të drejtë ta aplikojë këtë ndryshim jo më shumë se një herë në vit, si edhe jo më vonë se 2 muaj pas publikimit të INSTAT.
8. Informacionin e përditësuar në lidhje me zonat ndërkombëtare e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të internetit <https://www.one.al/>.